



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 17.11.2020, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Përshëndetje për të gjithë, i nderuar nënkryetar z. **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të LMT-së, përfaqësues të mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

R E N D I T E

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Koncept Planit për deponinë e mbeturinave të ngurta,**
3. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Koncept Planit për deponinë e mbeturinave të vëllimshme,**
4. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P-02279-0, 02280-0, 02281-0.**
5. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore,**
6. **Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përkujdesje dhe Mbrojtje të Fëmijëve dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik,**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, a jeni për këtë rend dite.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, nënkryetarin, anëtarët e Komitetit për Politike dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të LMT-se, OSBE-së, mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë do të propozoj edhe një pikë shtesë dhe kjo është ri-kategorizimi i zonës së mbrojtur tek Ura e Fshejtë për mbledhjen e Kuvendit. Pra të futet tash në KPF, pasi meqenëse çdo gjë është e përgatitur që nga viti 2017 ka qenë materiali gati mirëpo për shkak se ishte fundi i mandatit e kemi diskutuar që kemi prezent edhe disa prej anëtareve të kuvendit të mandatit të kaluar që kanë qenë. E patëm shtyrë për arsye të caktuara që të mos bëhet fushatë zgjedhore për shkak se ishte koha e zgjedhjeve. Por tani këtë pike ri kategorizimi i zonës së mbrojtur e propozoj për mbledhjen e sodit dhe të Kuvendit.

Kryesuesi - Faleminderit z. Fazliu, pra morëm një propozim nga z. Fazliu që për mbledhje te Kuvendit ta kemi edhe një pikë shtesë, Ri kategorizimi i zonës së mbrojtur tek ura e fshejtë apo Kanioni i Drinit të Bardhë. Të nderuar kolegë, a jeni për këtë pikë shtesë që ta kemi në Kuvendë. Pas votimit , konstatoj se do të kemi pikën shtesë për mbledhjen e rregullt të Kuvendit. Tani e qesim në votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Të nderuar kolegë kuvendarë, para se me fillua me pikën e parë të rendit të ditës, dua të ju informoj se ditën e djeshme na është kthyer nga MAPL-ja dy vendime për rishqyrtim. Vendimi i parë ka të bëjë me parcelën që kemi kaluar në mbledhjen e kaluar për parcelën me periudhe

afatgjatë ne Gexhë kurse vendimi tjetër është për dhënien në shfrytëzim për lokalet tek Palestra Sportive. Për këtë çështje e kisha ftuar zyrtarin ligjor z. Isak Hoti që të na jep disa sqarime.

Isak Hoti – Përshëndetje për kryesuesin, anëtarët e KPF-së dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Në mbledhjen e kalur është marrë një vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite në fshatin Gexhë, për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të fshatit dhe sipas Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kanë konsideruar që është në kundërshtim me ligjin dhe krejt çka kisha kërkuar tani është se ka mundësi se dy pika te rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme mundën me hy në rendin e ditës pa planifikim. Për vet faktin se para pak minute kam dërguar një shkresë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal përkatësisht monitorueses dhe Xhevat Tafës, drejtorit të departamentit për çështje ligjore ne Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Pasi për të njëjtën çështje konsideroj se po përdoret një mekanizëm i dyfishtë, ku në njërën anë në fshatin Radoste është marrë një vendim me datën 29.05.2020 për te cilin për te njëjtën çështje MAPL-ka na ka kthye pozitiv dhe ne përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore ne Republikën e Kosovës. Dhe për te njëjtën çështje i njëjti departament na ka kthye një vendim tjetër që ka thënë është në kundërshtim me ligjin. Tani me duhet që konsultohemi dhe të gjejmë një mundësi që me marr një përfundim se cilën po e marrim për bazë ose po e shfuqizojmë edhe këtë vendimin e fshatit Radoste ose po e miratojmë edhe këtë të fshatit Gexhë. Pasi konsideroj se po përdoret një mekanizëm i dyfishtë. Po ashtu është kthyer edhe vendimi tjetër për palestrën sportive, edhe këtu mendoj që MAPL-ja ndoshta e kanë stafin e reduktuar dhe nuk po mundën me i menaxhua qysh duhet. Kanë kërkuar certifikatat e secilit objekt në palestrën sportive, e që faktikisht aty është një certifikatë në tërësi, pra certifikatë kadastrale ne tërësi për te cilat për te njëjtën çështje ne kemi dhënë në shfrytëzim ku ne një objekt janë me shume se 5 lokale dhe për atë na kanë kthyer konfirmimin e ligjshmërisë se është në rregull ndërsa për këtë tjetrën na kanë thënë që duhet me pas secili lokal me pas certifikatën e pronësisë në vete, që edhe për këtë jemi duke diskutuar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal edhe me pae si me veprua tutje, por unë e di që gjithçka jemi në rregull me ligjin kurse ata nuk po pajtohen për këtë dhe te shohim tash si do të jetë përfundimi.

Kryesuesi - Faleminderit z. Hoti për sqarimin, të nderuar kolegë ne duhet te presim Zyrën Ligjore që është në kontakt te vazhdueshëm me MAPL-në dhe po besoj që të gjitha vendimet që na kanë kthyer dje që të jenë pozitive atëherë të kemi nevojë që me pas pika shtesë ne mbledhjen e rregullt të Kuvendit por nëse ndodh e kundërta atëherë do ti kemi këto dy pika shtesë. Tani po vazhdojmë me piken e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush diçka sa i përket Procesverbalit.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë kam një vërejtje në faqe 3, që me siguri ka qenë një lëshim dhe që sigurisht duhet me përmirësua, ne diskutimin tim shkruan viti 2010 e që ne fakt duhet me qenë 2019, që sigurisht duhet me u përmirësua kjo, diçka tjetër nuk kam.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkryetarin, kolegë këshilltarë të KPF-së, drejtorët dhe gjithë që janë prezentë në këtë sallë. Me duhet të bëj një ndërhyrje të vogël edhe unë që me siguri është një gabim teknik e që duhet të përmirësohet, tek diskutimi im te pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën janar –shtator 2020, ne faqe 4 ku po e lexoj, pastaj kodi 50405 shfrytëzimi i pronës publike, prapë planifikimi ka qenë 13,000 kurse te hyrat 2549 euro që ne përqindje i bie 90,6% e që në fakt duhet me qenë përqindja 19,6% që me siguri nuk është dëgjuar mirë në incizim apo është lëshim teknik.

Kryesuesi – Faleminderit për sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë, sekretaria do t'i përmirësoj këto gabime teknike dhe e qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Koncept Planit për deponinë e mbeturinave të ngurta.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për ju kryesues, përshëndetje për anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjithë ju të pranishëm ne sallë. Ne sot si drejtori i kemi ofruar dy koncepte të planeve të menaxhimit të mbeturinave, njërin për mbeturina të vëllimshme dhe njërin për të ngurta që janë të renditura sipas pikave te rendit të ditës që janë sot dhe kërkoj nga kuvendi i Komunës për shkak se është edhe obligim ligjor edhe për shkak të transparencës që me i futë edhe ne debat publik, që sot edhe merret një vendim nga ana e juaj që me i futë ne debat publik dhe kërkoj falje për materialin fizik që nuk ju kam sjellë, që realisht

është një material voluminoz për dy koncept planet mirëpo ne mbledhjen e kuvendit besoj që do ta keni të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe keni mundësi me i bë ato vërejtjet, sugjerimet e të gjitha. Kjo ishte tani dhe nëse keni diçka ju atëherë do të jem në dispozicionin tuaj.

Florida Bajraktari – Pra te pika, shqyrtimi i propozim vendimit për vënien në debat publik të koncept planit për deponimin e mbeturinave të ngurta siç e tha edhe drejtori që nuk ka sjellë materialin dhe nuk kemi material para vetes, kështu që veç desha informata shtesë se çka është koncept plani për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe çfarë materiali do të trajtohet në debat publik me qytetarët.

Fehmi Cena – Unë mendoj që drejtori edhe pse nuk e kemi materialin ndoshta kishte mundur ne pika të shkurta me na shpjegua se çka përmban ky koncept plan për deponimin e mbeturinave të ngurta siç do të vllente edhe për ato të vëllimshme. Pra, do të ishte mirë që në pika të shkurta me na sqarua neve anëtarëve të KPF-së, se çka në të vërtetë përmban kjo me disa fjali.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit ne sallë. Përveç asaj që u tha, ndoshta kur na shpjegon tash drejtori pak me detalisht për punën e kësaj deponie, unë dua të di që a kemi të bëjmë me një vend apo janë me shume se dy vende siç kemi folur me herët që me pas mundësi që qytetaret me pas qasje me afër. Pra a bëhet fjalë për një vend apo në dy e me shume vende, kjo po më intereson me ditë.

Përparim Krasniqi – Deponimi i mbeturinave të ngurta, bëhet fjalë për lokacionin që kemi në Rahovec dhe që kemi marr vendim për trajtimin e mbetjeve të ngurta siç është dheu, betoni edhe materiale tjera, pasi edhe me ligje janë të specifikuar se cilat janë mbeturinat e ngurta e cilat të vëllimshme. Plani është i përfshirë në tërë territorin e komunës së Rahovecit dhe ato vendime që janë marr për të gjitha. Mirëpo në vendimin tjetër që do ta kemi tash, pra do të merret një vendim për shkak se nuk kemi të interesuar kompani që dëshirojnë me marr deponinë me pagesë, d.m.th. e kemi shpallur ankandin dhe nuk ka pasur të interesuar me marr dhe tash po planifikojmë me marr një vendim tjetër me miratimin tuaj, që ideja është me futë ne sistem që me i trajtua ato, që me i futë edhe me i bo ndarjen. Te çështja e vëllimshme për ata që nuk e din, janë të gjitha ato mbeturina që përfshihen materiale mbetje të orendive shtëpiake si tavolina të prishura që sipas ligjit janë të specifikuar mirëpo janë të përfshira në territorin e komunës së Rahovecit. Këto koncept plane komuna e Rahovecit asnjëherë nuk i ka pasur dhe kjo është për herë të parë dhe e përcaktuar me ligje pasi krejt komunat e Kosovës janë të obliguara sipas Ministrisë me i pas këto dy koncept plane pasi shumë ma lehtë do ta ketë komuna e Rahovecit me fitue donacione, që bëhet me ndarje ne burim të mbeturinave tjera nëse aprovohet nga Ministria e Mjedisit. Pra ne vendimin tjetër që do ta kemi, për deponinë legale që kemi pasur ne ankand publik pasi nuk ka pasur të interesuar kompani dhe do ta shpjegojmë edhe njëherë ne detaje se çka do të bëhet me atë vendim dhe çka do të marrim me tutje vendim për këtë zonë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimin, atëherë kolegë të nderuar kalon për kuvend edhe pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Koncept Planit për deponimin e mbeturinave të Vëllimshme.

Përparim Krasniqi – Janë dy koncept plane që kanë shkuar paralel por për shkak se ka qenë kërkesë edhe e anëtareve të kuvendit që me i ndae një nga një vendimet por përndryshe këto dy koncept plane shkojnë bashkërisht pra do të hidhen ne debat publik dhe për shkak të materialit që ska mundur me punuar kompania me dërgua që me ju ofrua juve si anëtare të Komitetit për Politike dhe Financa që edhe kërkojmë falje mirëpo ne seancën tjetër do të keni dy koncept planet ne draft që do të i hedhim në debat publik dhe do të i shqyrtojmë edhe do të ndjekim procedurat ligjore.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderojmë drejtorin për këto pak informata që na dha e që sigurisht që u deshtë drejtori pak me u zgjerua se ne fakt nuk është që ne nuk e dimë por ka nevojë dikush me dhanë sqarime shtesë se çka janë mbeturinat e vëllimshme dhe kush hyn në mbeturinat të vëllimshme. Pra krejt këto pyetje që po pasojnë është se për shkak të mungesës së materialit pasi po të ishte materiali sigurisht se nuk do të ishin këto pyetje pasi do të ishin në material këto gjëra mirëpo për shkak të mungesës së materialit drejtori është mirë pak me u zgjerua në këtë temë. Po ashtu desha të pyes drejtorin pasi ju ka referua njëfarë udhëzimit administrativ d.m.th. këtu në hyrje të vitit 2008 dhe pyetja do ishte se a ka udhëzim administrativ për menaxhimin e mbeturinave të mëvonshme dhe pse keni marr këtë udhëzim të vitit 2008,

nëse mund të ketë udhëzim të pas vitit 2010 etj., pra e keni marrë udhëzimin administrativ më të hershëm shumë apo ndoshta nuk ka tjetër, që do të ishte mirë të na jepni sqarimet, pasi kam kërkuar diçka rreth kësaj edhe shoh që është ligji për mbeturina me numër 02/L-30 neni 4, që pak me herët u fol për mbeturinat se çka hyjnë në mbeturina të vëllimshme, ku aty shkruan se mbeturinat e vëllimshme janë mbetje me përmasa të mëdha, pajisjesh makinerish, grumbullimi transportimi dhe largimi i të cilëve bëhet në mënyrë të veçantë, pra kjo është ajo që e përkufizon neni 4.

Fehmi Cena – Kur e bëmë pyetje që drejtori me na dhanë shpjegime rreth koncept planit për deponinë e mbeturinave të ngurta, nuk është se ne nuk po e kuptojmë se çka përmban deponia e mbeturinave të ngurta pasi i kemi diskutuar këto edhe me përpara por pyetja ishte se çka përmban koncept plani që ju mendoni me dal në debat publik. Pra këtu kërkoja në pika të shkurta, si e keni menduar këtë pasi nëse ne e qesim në debat publik koncept planin, sigurisht që duhet me pas edhe propozime të komunës pra qeverisë apo drejtorisë se çka ne të ardhmen, në mënyrë që qytetarët të dinë se çka mendon komuna e pastaj se çka mendojnë ata. Pra kjo ishte ajo që ishte pyetje ndërsa sa i përket këtyre deponisë së mbeturinave të vëllimshme ka qenë e panjohur edhe për ne në përgjithësi dhe tash është e qartë edhe pse unë mendoj që tek ne nuk e di se si do të bëhet kjo ndarje pasi kur të hudhën mbeturinat e ngurta edhe krejt objekti shkatërrohet edhe hudhët në një vend. Dhe ju si do ta bëni këtë ndarje por sido qoftë nëpër komuna tjera po ndodh kjo atëherë duhet të ndodhë edhe në komunën tonë. Pra kjo është ajo se çka keni menduar ju me bo në hollësi për me hedhë në debat publik.

Përparim Krasniqi – E vërtetë është baca Rasim, se mbeturinat e vëllimshme llogariten gjësendet e vjetruara si orendi shtëpiake që hudhen mirëpo përmes këtij koncept plani do të i përgjigjen edhe doktorit. Pra, përmes koncept planit caktohet Komuna e Rahovecit që ta cakton një lokacion që do të bëhet ndarja në burim ku do të hedhen gjësendet e vjetra pastaj mbeturinat ngurta dhe përmes këtyre planeve tregon që ne të ardhmen se komuna e Rahovecit duhet me planifikua mjete buxhetore për me bo ndarjen në burim të këtyre mbeturinave d.m.th. të bëhet klasifikimi. Pra koncept plani është i harmonizuar me ligjin për mbeturina edhe strategjinë kombëtare të mbeturinave që 0/L-40 sipas ligjit të mbeturinave dhe tregon ndarjen në burim të gjithë atyre mbeturinave. Edhe njëherë kërkoj falje që nuk kam mundur me ju servue materialin për shkak se kompania nuk ka mundur me përgatit materialin me herët që me pas materialin ju sot para vetës që me mujt me shfletua dhe me pae koncept planin se çka përmban në tërësi. Pra janë dy koncepte që kanë material voluminoz dhe pas debatit publik do ta keni edhe ju dhe do ta shihni edhe me shume se çka përmban detalisht koncept plani për komunën e Rahovecit. Komuna e Rahovecit për herë të parë i ka këto edhe përmes këtyre koncept planeve mundet me qenë përfituese e grantit për vendosjen e një data baze ose një deponimi që do të bën edhe ndarjen në burim të mbeturinave. Pra shkurtimisht këto janë sa për sqarim mirëpo materialet tjera do ti keni krejt në mbledhjen e Nëntorit dhe do të kyçeni edhe ju sepse jepni vërejtje e sugjerimet për të gjitha koncept planet. Udhëzimi administrativ është i njëjtë që nga viti 2008 dhe nuk ka ndryshuar dhe ne e kemi zyrën ligjore që e kanë përgatit materialin që sigurisht se do të japin informata edhe me shume nëse ka ndonjë udhëzim të ri por me sa e di unë prej vitit 2008 Ministria e Mjedisit nuk ka bërë udhëzime tjera administrative por vetëm në bazë të ligjit të mbeturinave që ka ndryshua plotësim ndryshimi nuk ka bërë diçka tjetër në këtë aspekt, por sido qoftë zyra ligjore është këtu dhe na tregon nëse ka ndonjë udhëzim administrativ edhe tregon para juve këtu.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për sqarimet, të nderuar kolegë meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit për dhënin në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P – 02279-0, 02280-0, 02281-0.

Përparim Krasniqi – Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politike dhe Financa, siç edhe jeni në dijeni që e keni edhe arsyeshmërinë e vendimit, pas procedurave që i kemi ndjekë në kuvendin e komunës për deponinë legale të mbeturinave ka dështuar ankandi pasi nuk ka pasur të interesuar nga kompania për shkak mjeteve që është përcaktuar nga komuna e Rahovecit që është me rregullore në fuqi që ka qenë një vlerë goxha e madhe mbi 2000 euro që kompania duhet me ja ofrua komunës së Rahovecit për me marr në menaxhim atë zonë. Tash kërkoj nga ju që këtë vendim me shfuqizua vendimin paraprak pastaj që me nxjerr nga komuna e

Rahovecit që me bo pa pagesë, që kompania që do ta merr me menaxhue pa pagesë d.m.th. me ja ofrua komunës se Rahovecit mirëpo mbledhjen e mbeturinave me taksua sipas rregullores që kemi nxjerr edhe sipas vendimit për tarifë që kemi përcaktua ai do të mbetet në fuqi por vetëm të hiqet tarifa që është e përcaktuar me rregullore që ti paguhet komunës se Rahovecit. Po ashtu kemi marr vendim edhe për 3-4 zona tjera që realisht duhet me bo edhe për zona tjera si në Krushë, Dejn, Ratkoc, pra vlen për të gjitha zonat dhe jo vetëm për zonë legale që është këtu pra vlen edhe zona tjera që është përcaktua me vendim të kuvendit.

Fehmi Cena – Kërkoj një sqarim të shkurt nga drejtori për këto 3 parcela që janë të cekura këtu, po më intereson a janë të gjitha në kuadër të deponisë së qytetit të Rahovecit apo mos është ndonjë pjesë tjetër që është, thjesht po më intereson me ditë se a është e njëjta që kemi diskutuar edhe më herët.

Rasim Fazliu – Tani i morëm disa informacione se këto parcela të gjitha janë në të njëjtin vend mirëpo e shoh që ne pikën 2.1 ceket kategoria që është kullosë e klasës 5 dhe ne pikën 2.2 gjithashtu kullosë e klasës 5 kurse ne pikën 2.3 nuk ceket se cilës klasë i takon, që realisht do të ishte mirë edhe kjo të cekët se cilës klasë i takon. Pra, për mbledhje të kuvendit do të ishte mirë që t'i vendoset edhe kësaj emri nëse ekziston.

Përparim Krasniqi – Tek pjesa 2.3 është certifikata e pronësisë është ashtu e shkruar edhe në bazë të saj nuk guxojmë me bo asnjë ndryshim dhe kjo është arsyeja se nuk është e përcaktuar kategoria, përndryshe është e gjitha një parcelë e ndarë në 3 zona.

Kryesuesi - Faleminderit drejtor për sqarimin, atëherë të nderuar kolegë, meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar për pikën e katërt, konstatoj se kalon për Kuvend edhe pika e katër e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për ndërrim destinim të tokës bujqësore ne tokë ndërtimore.

Berat Duraku – Përshëndetje për nënkryetarin, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe gjithë të pranishmit në sallë. Para jush ju prezantoj kërkesën e parashtruar në Drejtorinë e Bujqësisë nga një qytetar i fshatit Opterushë Milit Haxhi Bytyqi i cili paraprakisht ka kërkuar edhe nga Drejtoria e urbanizmit për pajisje me leje ndërtimore për ndërtimin e shtëpisë. Drejtoria për Urbanizëm e ka ndryshuar kushtet ndërtimore për qytetarin në fjalë dhe ndër kushtet e tjera ka paraqitur edhe kërkesën për ndërrim destinim të tokës bujqësore. Parcela gjendet buzë magjistrales Rahovec – Suharekë në pjesën e poshtme të rrugës në kufi me zonën kadastrale me fshatin Zoqisht me sipërfaqe 5 ari e 60m². Në këtë lokacion veç tani kanë filluar të ndërtohen shtëpi qoftë me leje apo pa leje por qytetari në fjalë është duke kërkuar të pajiset me leje, pasi që kjo hapësirë nuk është në zonën ndërtimore atëherë kërkohet të bëhet ndërrim destinimi i tokës bujqësore ne tokë ndërtimore. Udhëzimi administrativ 41/2006 për ndërrim të tokës bujqësore, konkretisht neni 6, këtë kompetencë ja jep kuvendit komunal, pasi kategoria e klasës se tokës është në të gjashtë. Atëherë kërkoj nga ju që ta kalojmë për kuvend dhe pastaj kuvendarët të vendosin për ndryshim apo jo.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë nëse nuk ka diçka rreth kësaj pike, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Draftë rregullores për përkujdesje dhe mbrojtje të fëmijëve dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik.

Mirsad Shala – Përshëndetje për te gjithë, i nderuari kryesues i kuvendit, nënkryetar, anëtar të Komitetit për politikë dhe Financa dhe gjithë ju të pranishëm. Pas hyrjes ne fuqi të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve me datën 17 korrik 2020, Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me qendrën e trajnimeve dhe burimeve për avokim në partneritet me organizatën Save the Children in Kosova si dhe ne bashkëpunim me komunat e Republikës së Kosovës ka hartuar draft rregulloren unike komunale për të gjitha komunat në nivel vendi për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës. Qëllimi i hartimit të kësaj rregullore është mbrojtja e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, ndëshkimit trupor, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën dhe sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përcaktimin e detyrave dhe të subjekteve për mbrojtjen e fëmijës si dhe mënyrën e koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit të tyre me qëllim të kontributit në sistemin e mbrojtjes se fëmijës dhe kontributin në krijimin e një komune mike për fëmijët. Andaj pas diskutimit nga ana e juaj kërkoj nga ju që të merrni vendim për dalje ne debat publik të kësaj rregullore ashtu siç parashihet edhe me dispozitat e ligjeve në fuqi.

Kryesuesi – Siç e ceku edhe z. Shala që Save the Children dhe ARTC-ja kanë punuar vazhdimisht edhe janë në bashkëpunim edhe me nivelin qendror për të drejtat e fëmijëve edhe kjo draft rregullore na ka ardhë që ka

me qenë unike për te gjitha komunat e Republikat e Kosovës. Më herët e kemi pasur të aprovuar një rregullore mirëpo për këtë mbledhje kjo është për dalje ne debat publik rreth draft rregullores.

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar anëtarë të komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjithë të pranishmit. E kam shikuar mirë këtë rregullore, meqë edhe këtu e kemi për përcjelljen në Kuvend e po ashtu edhe ne debat publik, unë mendoj se si rregullore është e hartuar në përputhshmëri të çdo dispozite ligjore duke parë se janë përshkruar të gjitha specifikat me radhë që secili subjekt duhet të ketë vëmendje ndaj fëmijës mirëpo mendoj që do të ishte mirë që komuna e Rahovecit të jetë si komunë mike ndaj fëmijëve duke u bazuar në disa mangësi nga viti i kaluar edhe vitet paraprake ku patëm disa raste të abuzimit, madje abuzimit seksual të femrës në një ndërtesë afër shkollave të mesme këtu ne Rahovec e po ashtu abuzim i nxënësve në shkollën e mesme të lartë në fshatin Ratkoc, që ajo ka qenë dhunë ndaj fëmijëve ndaj nxënësve dhe uroj që komuna t'i shfrytëzoj të gjitha mekanizmat dhe dispozitat që ka duke i eliminuar edhe këto rrethana jo të mira për komunën e mbi të gjitha për fëmijët.

Rasim Fazliu – Kjo draft rregullore është mirë që duhet me dal para qytetarëve që secili me dhanë kontributin e vet dhe po ashtu është mirë që komuna jonë do ta ketë një rregullore për perkujdesje dhe mbrojtje të fëmijëve. Gjithashtu edhe ne pas debatit publik do të kemi kohë me diskutua pasi prapë do ta kemi në kuvend për miratim, por arsyeja që mora fjalën është me ngritë si çështje pasi kam qenë drejtpërdrejt i përfshirë në mësimdhënie për 45 vite, edhe të them të drejtën komuna jonë sidomos këto vitet pas çlirimit nuk kemi mundur të gjithë njerëzve e nxënësve me ju qëndrua përball e posaçërisht kategorisë nxënësve me nevoja të veçanta. Pasi unë kam pasur raste që ndoshta nuk kemi mundur me i sigurua një shkop për ecje apo gjëra tjera të nevojshme apo shume elementare për atë kategori të fëmijëve dhe uroj që kjo rregullore të plotësohet dhe të aprovojme ne si kuvend por shumë më e rëndësishme është që këtë rregullore pastaj ne si komunë që jemi me zbatua ne praktikë që edhe kësaj kategorie me ju dalë në ndihmë pra fëmijëve me nevoja të veçanta.

Mirsad Shala – Për sqarim, vitin e kaluar 2019 komuna e Rahovecit e ka miratuar një rregullore për realizimin e të drejtave të fëmijëve në kuadër të ligjit të punës. Kjo rregullore e re është perkujdesur në mbrojtjen fëmijëve në bazë të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, kështu që janë dy rregullore të ndryshme.

Kryesuesi – Faleminderit z. Shala për sqarimin, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Të ndryshme.

Atëherë nëse nuk ka dikush diçka rreth pikës se shtatë, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e rregullt të Kuvendit.

Mbledhja përfundoj 11:00

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

